

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“The Çaçë” sh.p.k**

Titulli I

**Emërtimi – objekti
Selia – kohëzgjatja**

Neni 1

Sot në Tiranë më datë 03.09.2021, ne Ortakët dhe themelues të shoqërisë :

- **NIKOLIN LLESHI**, i biri i Dod dhe i Metër, i datëlindjes 19.03.1967, lindur në Delbnisht Krujë dhe banues në Tiranë, me adrese Rruga Gjon Pali II, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit ID me Nr. G70519194R., madhor e me zotësi juridike të plotë për të vepruar.
- **ALDO LLESHI**, i biri i Arben dhe i Alketa, I datëlindjes 05.12.1999, lindur në Rreshen, Mirditë dhe banues në Tiranë, me adrese Ish parku autobusave, Rruga “Babe Rexha” identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit ID, me Nr. J91205043L., madhor e me zotësi juridike të plotë për të vepruar.
- **ERGYS KONDA**, i biri i Solli dhe i Aurora, I datëlindjes 05.07.1989, lindur në Elbasan dhe banues në Elbasan, me adrese Ish parku Autobusave Rruga “Dyli Haxhire”, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit ID me Nr. I90705111P, madhor e me zotësi juridike të plotë për të vepruar.

Vendosëm të themelojm shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “The Çaçë” shpk.

Neni 2

Objekti i aktivitetit të shoqërisë “The Çaçë” sh.p.k është:


2.1 Dyqan Shitje produkte ushqimore, ëmbelsira, paketime kafe, sherbim delivery, sherbim take-away, aktivitet ne fushen e import-eksportit, përpunimit dhe tregtimit me shumice dhe pakice te kafese dhe nenprodukteve te saj, bar kafe.

2.2 Ne fushen e zhvillimit te turizmit, te hapjes se hoteleve, restoranteve, bareve.

2.3 Hapja,menaxhim dhe shfrytezim te cdo lloj madhesie baresh, restorantesh, fast food, diskotekash dhe lojra argetuese per femije, qender sportive, qender pushimi dhe kurative. Shoqëria mund të kryejë edhe çdo lloj aktiviteti tjetër ndihmës dhe të nevojshëm, që ka lidhje të mjaftueshme me këtë objekt aktiviteti dhe që nuk ndalohet nga ligjet Shqiptarë në fuqi.

Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj në çdo kohë sic parashikohet në këtë statut.

Shoqëria mund të marrë te drejtën e përfaqësimit në Shqipëri të individëve, shoqërive apo organizatave vendase apo të huaja .



Neni 3

- 3.1 Selia e shoqërisë “ **The Çaç**” sh.p.k do të jetë në Rruga “Bulevadi blu” pallati “Univers Center”, kati 7 perballe “Universitetit Bujqesor” Kamez.
- 3.2 Selia e shoqërisë mund të transferohet kudo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë me një vendim të Asamblesë së ortakëve të shoqërisë.

Neni 4

Residenca ligjore e Ortakëve për çdo raport me shoqërinë është selia e shoqërisë

Neni 5

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pakufizuar.

Neni 6

Shoqëria mund të krijojë degë apo përfaqësi të saj brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Titulli II

Kapitali Të shoqërisë dhe Kuotat

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontribute në të holla me vlerë prej 100 000 (njëqindmijë) lekë, e cila do të depozitohet në llogari të shoqërisë, në një Bankë të nivelit të dytë, pas regjistrimit në QKB .

Neni 8

Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar

Ortakët e Shoqërisë dhe kuotat e zotëruar prej tyre në Shoqëri janë si më poshtë:
Nikolin LLESHI zotëron 1 kuotë që përfaqëson 20% të kapitalit të Shoqërisë.
Aldo LLESHI zotëron 1 kuotë që përfaqëson 50% të kapitalit të Shoqërisë.
Ergys KONDA zotëron 1 kuotë që përfaqëson 30% të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 9

Çertifikata e kuotave

- 9.1 Secili ortak ka të drejtë të përfitojë një çertifikatë për kuotën e zotëruar prej tij. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një çertifikatë për kuotat e zotëruara bashkarisht nga disa persona dhe dorëzimi i çertifikatës ndaj përfaqësuesit të zotëruesve të kuotave , në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit .
- 9.2 Emrat e zotëruesve të përbashkët të kuotave do të renditen në çertifikatën e kuotës.
- 9.3 Çertifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letres me vlerë.

Neni 10

- 10.1 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme midis ortakëve.

- 10.2 Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - ç) dhurimit;
 - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj..
- 10.3 Në rast se një ortak do të shesë, transferojë, ose të disponojë në mënyra të ndryshme pjesë apo të gjithë kuotën e tij, Ortaku tjetër do të ketë të drejtën e parablerjes, kundrejt blerësve të tjerë. Nëse Ortaku me të drejtë parablerje do të ketë bërë një ofertë dhe kjo ofertë është refuzuar nga Ortaku që shet, atëherë Ortaku që shet nuk do të ketë të drejtë të shesë kuotën tek një blerës tjetër me cmim më të ulët se cmimi i ofruar nga Ortaku i preferuar.
- 10.4 Njoftimi për shitje do të bëhet me shkrim. Nëse brenda një muaji askush nga ortakët e shoqërisë nuk ofrohet për t'i blerë, atëherë shitësi është i lirë t'i shesë kuotat jashtë bashkësisë së shoqërisë.
- 10.5 Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e rregjistrimit të kalimit të kuotave.
- 10.6 Shoqëria regjistron kalimin e kuotës sipas nenit 43 të ligjit "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.
- 10.7 Transferimi i kuotave ortakëve të shoqërisë apo të tretëve që nuk bëjnë pjesë në shoqëri do të bëhet me shkrim dhe do të vërtetohet nga Noteri Publik.

Neni 11

Blerja e kuotave të veta

Shoqëria mund të blejë kuotat e veta, dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre. Këtë mund ta bëjë vetëm nëse shoqëria ka aftësi paguese, sipas termit dhe përkufizimeve të nenit 77 të ligjit. Nëse nuk respektohen parashikimet e ligjit për këtë qëllim, atëherë mund të ngrihen padi qoftë kundër administratorit ashtu edhe kundër shoqërisë.


Titulli III

Asambleja e Përgjithshme

Neni 12

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë thirret nga Administratori/Administratorët I/E shoqërisë në çdo kohë kur e kërkojnë jo më pak se 5 % e kuotave të kapitalit të shoqërisë (personat që zotërojnë këtë përqindje kapitali). Në kërkesën e tyre ortakët sa më sipër duhet të rendisin shkaqet se përse kërkohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme. Me të marrë këtë kërkesë Administratori/Administratorët i/e shoqërisë është i detyruar të caktojë datën e mbledhjes dhe të bëjë njoftimet përkatëse sipas ligjit.
- 12.2 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (*e-mail*) drejtuar çdo Ortaku përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara datës së caktuar për mbledhjen, përveç rasteve kur njoftimi i mbledhjes



së Asamblesë së Përgjithshme , I cili përmban një afat më të shkurtër është miratuar nga shumica e ortakëve të cilët zotërojnë jo më pak se 80 % të kapitalit të shoqërisë . Secilit ortak.

- 12.3 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme janë të pavlefshme në rast moskryerje të paqëllimshme të njoftimit apo mosmarrjes së njoftimit të mbledhjes nga personat të cilët kanë të drejtë të marrin këtë njoftim, me përjashtim të rastit kur shoqëria provon se personi I ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.

Neni 13

Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

- 13.1 Asambleja e Përgjithshme merr vendime të zakonëshme të vlefshëm, me shumicë votash vetëm nëse në mbledhjen e saj marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë jo më pak se 50 % të kuotave të kapitalit të shoqërisë.
- 13.2 Për vendimet e asamblesë lidhur me: ndryshimin e statutit, zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, mbledhja e asamblesë është e vlefshme nëse në të marrin pjesë ortakë me të drejtë vote (vetë ose të përfaqësuar) që zotërojnë jo më pak se 70 % të kuotave të kapitalit. Vendimet e asamblesë për çështjet sa sipër duhet të merren nga jo më pak se 3/ 4 e votave të ortakëve pjesëmarrës.
- 13.3 Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (*conference call*), audio ose audio –video, në përputhje me nenin 88 të Ligjit.
- 13.4 Administratori/Administratorët cakton Kryetarin e mbledhjes si dhe një person për të mbajtur procesverbalin e mbledhjes.
- 13.5 Nëse Administratori/Administratorët nuk dëshirojnë të caktohet si kryetar I mbledhjes ose nëse administratori nuk është I pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes , ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si kryetar të mbledhjes.
- 13.6 Administratori , (edhe kur nuk është ortak) ka të drejtën e pjesëmarrjes si dhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.
- 13.7 Kryetari , me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj , mund (dhe është I detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme) të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato Çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme shtyhet të paktën katërmbëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktën shtatë ditë të Plota përpara kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi I mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi I përgjithshëm I rendit të ditës. Në rast të kundërt , dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.
- 13.8 Asambleja vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet në mënyrën e duhur një votim I fshehtë. Votimi I fshehtë mund të kërkohet nga :
- Administratori;
- Një ortak ose ortakët që përfaqësojnë të paktën pesë përqind të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një përfaqësues I autorizuar I Ortakëve ka të njëjtën vlerë me kërkesën e paraqitur nga vetë Ortakët .

- 13.9 Me përjashtim të kundërshtimit të një Ortaku deklarimi I kryetarit se vendimi është marrë në mënyrë unanime, ose me shumicë të caktuar, nuk është miratuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi përkatës në procesverbalin e mbledhjes përbën provë përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë për numërimin e votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.
- 13.10 Në rast se ka kundërshtime për këtë deklaratë do të zhvillohet një votim I fshehtë në lidhje me përcaktimin e numrit të votave pro dhe kundër vendimit.

Neni 14 **Votat e Ortakëve**

- 14.1 Në përputhje me të drejta ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë I jep Ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit e tij të autorizuar ose Ortakut (në rastin kur është person juridik) I cili është I pranishëm përmes përfaqësuesit të tij ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.
- 14.2 Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme , personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve , në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.
- 14.3 Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do ti komunikohet Kryetarit, vendimi I të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.

Neni 15 **Votimi me Prokurë**

- 15.1 Përfaqësuesi do të emërohet nga Ortaku në formën e zakonshme apo në formën që mund të caktohet nga administratori). Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga administratori depozitohet në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emërimit të duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.
- 15.2 Në rast se akti i emërimit të përfaqësuesit jepet nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar në adresën elektronike (email) sipas përcaktimeve të pikës 3 e të nenit 4 të këtij Statuti , ky akt duhet të merret jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

Neni 16 **Të Drejtat dhe Detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për shoqërinë për marrjen e vendimeve të mëposhtme:

- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- Ndryshimet e statutit të shoqërisë;
- Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;

- Përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërisë;
- Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë;
- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Përfaqësimin e shoqërisë në Gjykatë dhe në procedimet e tjera kundër Administratorëve;
- Riorganizimin, ndarjen, prishjen dhe likuidimin e shoqërisë.

Neni 17 Hetimet e posaçme

- 17.1 Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë të vendosë fillimin e një hetimi të posaçëm gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare dhe për këtë cakton një ekspert të fushës përkatëse.
- 17.2 Ortakët që përfaqësojnë jo më pak se 5 % të kuotave të kapitalit dhe çdo kreditor I shoqërisë mund t'i kërkojnë Asamblesë së Përgjithshme të emërojë për qëllime hetimi një ekspert të pavarur të fushës. Në këtë rast nëse Asambleja brenda 60 ditëve nga depozitimi I kërkesës nuk mer vendim, kërkesa e subjekteve sa sipër vlerësohet e refuzuar. Nëse subjektet e mësipër dyshojnë në performancën e ekspertit mund ti kërkojnë Gjykatës zëvendësimin e tij.

Neni 18 Largimi dhe Përrjashtimi I Ortakëve

- 18.1 Secili ortak mund të largohet nga shoqëria nëse për çfarëdolloj shkak që ai çmon se vazhdimi I ortakërisë është I pamundur. Për këtë Ortaku duhet të njoftojë me shkrim shoqërinë, në të cilin duhet të parashtrijë dhe shkaqet e largimit. Nëse vërtetohet një rast I tillë Administratori I Shoqërisë duhet të thërrasë mbeldhjen e Asamblesë dhe do të procedohet sipas gjithë parashikimeve të neniti 101 të Ligjit.
- 18.2 Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë mund t'i kërkojë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë përjashtimin e Ortakut të shoqërisë, për gjithë shkaqet e parashikuara në nenin 102 të Ligjit. Edhe për procedurën e mëpasme do të respektohen gjithë parashikimet e këtij neni.

Titulli IV Administrimi

Neni 19

Shoqëria "The Eëäa" sh.p.k do të administrohet nga dy administratorë, të cilët kanë të drejtë veprojnë të dy sëbashku apo veç e veç.

- **ALDO LLESHI**, i biri i Arben dhe i Alketa, I datëlindjes 05.12.1999, lindur në Rreshen, Mirditë dhe banues në Tiranë, me adrese Ish parku autobusave, Rruga "Babe Rexha".
- , identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit ID, me Nr. J91205043L., madhor e me zotësi juridike të plotë për të vepruar.

- **ERGYS KONDA**, i biri i Solli dhe i Aurora, I datëlindjes 05.07.1989, lindur në Elbasan dhe banues Elbasan, me adrese Ish parku Autobusave Rruga "Dyli Haxhire", identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit ID me Nr. I90705111P, madhor e me zotësi juridike të plotë për të vepruar.

Kohëzgjatja e detyrës së administratorve është 1 (një) vit me të drejtë rizgjedhje.

Neni 18

Të Drejtat dhe Detyrat e Administratorit

Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen:

Të kryjë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;

Të përfaqësojnë shoqërinë tregtare në marrëdhënie me të tretët dhe me gjithë institucionet shtetërore në nivel vendor dhe qendror, madje përfaqësimi i shoqërisë në instancat gjyqësore, administrative;

Të kujdeset për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;

Të përgatisin dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportini e ecurisë së veprimtarisë si dhe propozimet për shpërndarjen e fitimit, duke ia paraqitur këto për miratim Asamblesë së shoqërisë;

Të raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve me rëndësi të posaçme për shoqërinë.

Të kryejnë regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë sipas parashikimeve të ligjit "Për Qendrën Kombëtare të Bisnesit".

Asambleja e Përgjithshme mund ta shkarkojë në çdo kohë administratorët e shoqërisë me shumicë të zakonshme. Zgjidhja e menjëherëshme e kontratës së punës me administratorët do të bëhet në bazë të parashikimeve të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Neni 20

Administratorët e shoqërisë janë të detyruar të jenë besnik ndaj shoqërisë dhe ortakëve të saj, sipas parashikimeve të neneve 14, 15, 17 e 18 të Ligjit Nr. 9901, dt. 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Administratori I shoqërisë, është I detyruar të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në këtë statut në mirëbesim dhe në interesin më të lartë të shoqërisë. Administratori është I detyruar t'i ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe me kujdesin e nevojshëm.

Administratori I shoqërisë përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë, me përjashtim të rastit kur në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatës, veprimi apo mosveprimi është kryer në mirëbesim. Nëse vërtetohet rasti sa sipër Administratori është I detyruar të shpërblejë shoqërinë për çdo dëm të ardhur, si dhe të kthejë çdo përfitim që ai vetë apo personat e lidhur me të kanë realizuar për shkak të veprimeve të paligjshëm.

Neni 21 Shpërblimi I Administratorit

Shpërblimi për administratorin, tej shpenzimeve të ndodhura gjatë kryerjes së detyrave normale të administrimit të shoqërisë, do të përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë. Shpërblimit bazë të administratorit mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim apo të ngjashme.

Titulli V Balanci dhe mjetet


Neni 22

Çdo vit financiar fillon në Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor të çdo viti, duke përfshirë vitin e parë i cili fillon në momentin e regjistrimit të shoqërisë. Llogaritë vjetore, inventarët, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçantë të hartuara nga Administratori dhe eventalisht nga ekspertë kontabël të autorizuar, miratohen nga Asambleja me shumicë votash (shumicë që përfaqëson më shumë se 1 / 2 e kapitalit të shoqërisë). Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore të Shoqërisë bëhet brenda një afati prej tre muajsh nga dita e mbylljes së vitit financiar.

Titulli VI Dividentet dhe Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Neni 23 Dividentët

- Pas plotësimit të parashikimeve të nenit 77 të Ligjit, Shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave të Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividentëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividentët deklarohen dhe paguhet në përputhje me shumën e paguar për kuotat për të cilët paguhet dividenti. Të gjithë dividentët pjestohen dhe paguhet në përpjestim të drejtë me shumën e paguar për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividenti; në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividentit nga një datë e caktuar, dividenti do të paguhet në përputhje me këtë kusht.
- Asnjë divident ose pagesë në para që lidhet me një kuota nuk do të marrë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.
- Çdo divident që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset me shumicë të kualifikuar votash nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.



Neni 24
Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Administratori, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

Titulli VII
Prishja dhe likuidimi

Neni 25

Shoqëria priset në të gjitha rastet e parashikuara nga ligji. Shoqëria mund të priset në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme shoqërisë kur për këtë vendosin jo më pak se $\frac{3}{4}$ e kapitalit të shoqërisë.

Neni 26

Shoqëria hyn në likuidim në momentin e prishjes së saj. Asambleja e Përgjithshme do të përcaktojë modalitetet e likuidimit si dhe do të emërojë një ose më shumë likuidatorë. Likuidimi i shoqërisë do të bëhet sipas dispozitave ligjore.

Titulli VIII
Mardhëniet e punës

Neni 27

Mardhëniet e punës midis shoqërisë dhe të punësuarve do të përcaktohen nga kontrata individuale dhe kolektive e punës. Për ato çka nuk parashikohet në këto kontrata do të zbatohet legjislacioni ekzistues i punës.


Titulli IX
Kompetenca gjyqësore

Neni 28

Çdo mosmarëveshje që mund të lindë lidhur me interpretimin e këtij statuti apo akteve të tjera të shoqërisë, ose mosmarëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë do të zgjidhen me mirëkuptim. Në rast se ky nuk arrihet kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 29
Njoftimet

- Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit , duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.
- Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke i dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të Ortakëve ose në adresën apo postën



elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga Ortakët. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote , të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të ligjit.

- Ky statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentat e tjera , raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga shoqëria do të publikohen nga administratori në faqen e internetit të shoqërisë , sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 4 të këtij Statuti (nëse zbatohet).

Të tjera

Cdo gjë tjetër, e cila nuk është përmendur në këtë statut, do të rregullohet nga dispozitat e Ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.


Titulli X Dispozita të përgjithshme

Neni 30


Për atë çka nuk është thënë shprehimisht në këtë statut do të referohet në ligjin 9901, dt. 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodin Civil, si dhe në ligje të tjerë Shqiptarë në fuqi.

ORTAKËT THEMELUES

NIKOLIN LLESHI



ALDO LLESHI



ERGYS KONDA

